

The background features a large, abstract, low-poly blue shape that resembles a map of Kosovo. The shape is composed of various shades of blue, from light to dark, creating a sense of depth and texture. It is set against a white background.

**Matja e perceptimit publik,
dhe dialogu publik, për Komisionin
e ardhshëm për të Vërtetën
dhe Pajtimin (KVP) në Kosovë**

Matja e perceptimit publik, dhe dialogu publik, për Komisionin e ardhshëm për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP) në Kosovë

Impressum

Nora Ahmetaj, (autore)

Kathelijne Schenkel, PAX (autore)

Kelli Muddell, ICTJ (redaktore)

Mateo Porciuncula, ICTJ (redaktor)

Bleona Bicaj, UBO consulting (analiza e të dhënave të sondazhit)

Tringa Krasniqi, UBO consulting (analiza e të dhënave të sondazhit)

Kushtrim Koliqi, Integra (botues)

Mirënjohje

Fuqizuar nga Integra

Në partneritet me Nismën e Re Sociale (NRS)

Autorizuar nga Ekipi Përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin

Mbështetur nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë, Ambasada e Zvicrës në Kosovë dhe Fondacioni i Vëllezërve Rockefeller

Duke faleminderuar Qendrën Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT) dhe PAX për këshilla dhe rishikim të gjithëmbarshtëm

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

- Gjetjet kryesore

Hyrje

Metodologjia

- Hulumtim kuantitativ
- Hulumtim kualitativ

Gjetjet

- Profili demografik i të anketuarve
- Pikëpamje mbi të vërtetën, pajtimin dhe aktorët kryesorë
- Pikëpamje për pajtimin
- Njohuri mbi Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin
- Pikëpamje drejt Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin
- Parapëlqimet për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovën

Përfundime

Rekomandime

Lista e figurave

- Figura 1. A i përkisni ndonjëres prej këtyre kategorive të krijuara me ligj?
- Figura 2. Si e vlerësoni ndryshimin në fushat vijuese që nga përfundimi i luftës?
- Figura 3. Si e vlerësoni ndryshimin në fushat vijuese që nga përfundimi i luftës?
- Figura 4. A keni dëgjuar ndonjëherë për të drejtën për të vërtetën?
- Figura 5. A mendoni se është e rëndësishme që viktimat dhe familjet e tyre ta dinë të vërtetën?
- Figura 6. Pse mendoni se nuk është e rëndësishme?
- Figura 7. A mendoni se e drejta për të vërtetën është e rëndësishme edhe nëse...:
- Figura 8. Çka do të thotë për ju "pajtim" kur mendoni të merreni me të kaluarën në Kosovë?
- Figura 9. Sipas mendimit tuaj, pajtimi duhet të bëhet ndërmjet: (sipas etnisë)
- Figura 10. Sa të rëndësishme e shihni përkrahjen këtyre akterëve dhe iniciativave për arritjen e pajtimit në Kosovë?
- Figura 11. Ju lutemi na tregoni nëse pajtoheni ose jo me deklaratat vijuese?
- Tabela 1.** Ju lutemi na tregoni nëse pajtoheni ose jo me deklaratat e mëposhtme? Sipas etnisë
- Figura 12. A keni dëgjuar ndonjëherë për idenë e themelimit të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë?
- Figura 13. Sa do të thoshit se dini për KVP?
- Figura 14. Në dritën e këtij informacioni, si ndjeheni për krijimin e KVP-së? Sipas etnisë
- Figura 15. Në parim, a e mbështetni krijimin e KVP-së? Sipas etnisë
- Figura 16. Cila është arsyeja kryesore për ta përkrahur KVP kundrejt arsyes kryesore për të mos e përkrahur?
- Figura 17. Cilat lloje të shkeljeve të të drejtave të njeriut duhet të mbulojë KVP?
- Figura 18. Cilat lloje të shkeljeve të të drejtave të njeriut duhet të mbulojë KVP? Sipas etnisë
- Figura 19. Cilën periudhë mendoni se duhet ta mbulojë KVP? Nga... deri...
- Tabela 2.** Cilën periudhë mendoni se duhet ta mbulojë KVP? Nga... deri... (pyetje e hapur)
- Figura 20. Cilët aktorë mendoni se duhet t'i shqyrtojë/studiojë KVP? Sipas etnisë
- Figura 21. Cilat nga rezultatet e dhëna mendoni se duhet t'i arrijë KVP?
- Figura 22. A pajtoheni apo jo me pohimet e lartpërmendura?
- Figura 23. Për ju, a do të kishte KVP më shumë ose më pak besueshmëri nëse...
- Figura 24. Kush mendoni se duhet të përfshihet në hartimin e aktit normativ për themelimin e KVP?
- Figura 25. Në lidhje me komisionerët e KVP, a mendoni se duhet të ketë kuota për të siguruar përfaqësim adekuat të:
- Figura 26. Kush mendoni se duhet të zgjedhë komisionerët e KVP?
- Figura 27. Kush mendoni se duhet të jetë përgjegjës për buxhetin e KVP?
- Figura 28. Kush mendoni se duhet të monitorojë KVP-në?
- Figura 29. Në fund të punës së vet, KVP do të publikojë një raport me gjetjet. Si mendoni se duhet të publikohet ky raport?
- Figura 30. Si mendoni se duhet të sigurohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti nga institucionet përkatëse?

Figura 31. Me supozimin se KVP do të themelohet dhe do të performojë në bazë të preferencave që ju ofruat, a do të mbetesh ende ndonjë aspekt që t'ju pengonte të keni besim në KVP?

Lista e akronimeve

OShC(të)	Organizatat e Shoqërisë Civile
GF(të)	Grupet e Fokusit
APJ	Armata Popullore Jugosllave
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
OJQ	Organizatë joqeveritare
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
EP	Ekipi Përgatitor (për krijimin e KVP)
KVP	Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin

Përmbledhje e përgjithshme

Njëzet vjet pas konfliktit, Kosova ende duhet të merret në mënyrë efektive me trashëgiminë e dhunës masive dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Që nga viti 1999, qasja e të marrit me të kaluarën në Kosovë ka qenë jokonsistente dhe e papërshtatshme. Krimet e luftës janë gjykuar nga gjykatat ndërkombëtare (ICTY), prej institucioneve ndërkombëtare (UNMIK dhe EULEX) dhe në gjykatat kombëtare. Ndonëse drejtësia për krimet e luftës është me rëndësi, përqëndrimi në gjykimet e tilla shpërfillte investimet serioze në mjetet e avancimit të bashkëjetesës dhe të pajtimit. Përpyekjet e hartuara deri më tani në Kosovë për ta arritur pajtimin nuk kanë dhënë rezultatet e pritura, sidomos pasi nuk ka pasur ndonjë interes serioz politik dhe as investime, si dhe për mungesë të një kuptimi konkret dhe të vlefshëm të mekanizmave që janë parësor për pajtimin.

Ndjesia e mungesës së vënies së drejtësisë, si dhe mungesa e pranimit dhe njohjes së shkeljeve dhe dëmeve të pësura nga viktimat gjatë konfliktit të armatosur janë bërë pengesa për bashkëpunimin dhe pajtimin ndërkosovar, si dhe zhvillimin e shoqërisë deri më tani. Kosova ndodhet në udhëkryq në përballje me betejat që vijnë me sovranitet të plotë. Një test i aftësisë së Kosovës për të funksionuar si shoqëri gjithëpërfshirëse e përparimtare përfshin kryesisht trajtimin e trashëgimisë së konfliktit të viteve 1998-99 dhe pasojave të tij.

Në vitin 2017, Presidenti i Kosovës dha idenë për themelimin e një Komision për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP) për Kosovën, për të cilin aktualisht po punon një Ekip Përgatitor (EP). Ky raport është rezultat i një hulumtimi të anketës së perceptimit për të informuar Ekipin Përgatitor mbi njohuritë dhe pikëpamjet e shoqërisë kosovare lidhur me konceptet e të vërtetës, pajtimit dhe KVP-së së propozuar për Kosovën. Hulumtimi tregon qartë se vetëdijesimi i publikut për krijimin e KVP, për qëllimin, mandatin dhe fushën e funksionimit të tij është jashtëzakonisht i ulët.

Sondazhi u krye me 1065 të anketuar që përfaqësonin të gjitha komunitetet etnike në Kosovë, i pasuar nga seanca cilësore të Grupit të Fokusit me grupe monoetnike për të diskutuar më tej konceptet e të vërtetës dhe të pajtimit. Shumica e të anketuarve mendojnë se pajtimi është i nevojshëm dhe se e vërteta dhe drejtësia janë parakushte të rëndësishme për ta arritur, ndërkohë që njohja e saj është proces i gjatë. Në këtë sens, shumica e të anketuarve përkrahin themelimin e KVP-së, edhe nëse kjo do të zbulonte gjëra negative mbi grupin etnik të vet ose fakte për të cilat ata nuk ishin në dijeni. Sidoqoftë, ka dallime të dukshme, veçmas midis shqiptarëve dhe serbëve, kur është fjala për periudhën kohore, aktorët dhe krimet që do të hetohen nga KVP. Në përgjithësi, njerëzit brengosen se sistemi i dobët i drejtësisë në Kosovë dhe çështjet e korrupsionit mund të ndikojnë në punën e KVP. Ekipi Përgatitor duhet të sigurohet që mandati i KVP të përfshijë gjithë këto këndvështrime të ndryshme dhe që KVP të jetë në gjendje të punojë në mënyrë plotësisht të pavarur dhe transparente.

Gjetjet kryesore

- Shumica e të anketuarve (62%) kurrë nuk kanë dëgjuar për të Drejtën për të Vërtetën për viktimat e abuzimeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën. Vetëm pas një shpjegimi të shkurtër, shumica mendonin se është shumë e rëndësishme (80%) që viktimat dhe familjet e tyre të dinë të vërtetën. Këtë besim e pati shumica, pavarësisht se çka do të zbulonte e vërteta. Ata që nuk e panë si të rëndësishme të drejtën për të vërtetën, nuk besuan as se e vërteta do të ndryshonte ndonjë gjë.
- Studimi zbulon se koncepti i pajtimit kuptohet si paqe (ulja e dhunës dhe vendosja e paqes) dhe respektim i të drejtave të njeriut të një individi nga një shumicë dërrmuese e të anketuarve (83%).
- Për të arritur pajtimin në Kosovë, të anketuarit u pajtuan në masë të madhe se është e domosdoshme gjetja e të vërtetës (90%), si dhe drejtësia juridike (88%).
- 63% e të gjithë të anketuarve besojnë se pajtimi duhet të bëhet ndërmjet entiteteve përkatëse. Sidoqoftë, shqiptarët e Kosovës i konsiderojnë qeverinë e Kosovës dhe atë serbe si subjektet kryesore për realizimin e pajtimit, ndërsa shumica e serbëve të Kosovës besojnë se kjo duhet bërë ndërmjet komuniteteve.
- Shumica e të anketuarve (72%) kurrë nuk kanë dëgjuar për nismën për një KVP për Kosovën, dhe vetëm 14% kanë dëgjuar.
- Pasi të anketuarve iu dha informacion shtesë për KVP, shumica (76%) ndiheshin pozitivisht për të. Sidoqoftë, duke i zbërthyer etnikisht, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve shqiptarë (79%) ishin pozitivë, ndërsa më pak se një e treta (29%) e të anketuarve serbë ndiheshin pozitivisht për këtë, kurse 50% nuk u përcaktuan ose ndjeheshin neutralë ndaj kësaj dhe 14% u shprehën negativisht.
- Përderisa vetëm 3% e të gjithë të anketuarve nuk do ta përkrahnin krijimin e KVP-së në Kosovë, 19% e serbëve në Kosovë nuk do ta bënë këtë.
- Arsyeja kryesore që pjesëmarrësit përkrahin krijimin e KVP-së ishte zbulimi i të vërtetës (39%).
- Në mesin e atyre që nuk e mbështesin krijimin e KVP-së, 26% besojnë se KVP nuk do të ketë sukses, dhe 21% janë negativë për faktin se nisma erdhi nga Presidenti i Kosovës, Z. Hashim Thaçi.
- Disa të anketuar (12%) nuk e mbështesin KVP-në sepse mendojnë që falja do të kërkohej nga viktimat dhe Komisioni do të merrej me faljen e krimeve të kryera gjatë konfliktit të fundit në Kosovë.
- Vrasjet masive (66%) dhe dhuna seksuale (63%) ishin dy shkeljet më të zgjedhura për t'u mbuluar nën mandatin e KVP-së. Rezultati më i rëndësishëm që duhet ta arrijë KVP, sipas të anketuarve, është që familjarët e personave të zhdukur të dinë çka ka ndodhur me të dashurit e tyre (69%).
- Ngjashëm, ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet të anketuarve shqiptarë dhe serbë të Kosovës lidhur aktorët përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut që duhet të hetohen nga KVP.

- Nuk kishte konsensus të qartë midis të anketuarve për periudhën e saktë të dhunës që do të hetohej nga KVP.
- Në kuptimin e themelimit zyrtar, shumica e të anketuarve (66%) mendojnë se KVP duhet të themelohet me akt legjislativ që të ketë besueshmëri. Për më shumë, Kuvendi i Kosovës shihet si i rëndësishëm për emërimin e komisionerëve (bazuar në një listë emërimesh të ofruar nga një komision përzgjedhës i përbërë nga viktimat e luftës, OJQ-të, mediat dhe publiku i përgjithshëm), si dhe për miratimin dhe kontrollin e buxhetit për KVP dhe monitorimin e punës së tij.
- Shumica e të anketuarve janë pajtuar se duhet të ketë kuota për të siguruar përfaqësim adekuat të grave (84%) dhe të pakicave (77%) si komisionerë të KVP.
- Shumë të anketuar e konsiderojnë tejet të rëndësishme që nëse KVP themelohet, ai duhet të jetë plotësisht i pavarur, transparent - duke i mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët - dhe që rekomandimet e tij të zbatohen. Shumica besojnë se raporti përfundimtar i KVP duhet të publikohet dhe të vihet në dispozicion të publikut të gjerë si në internet ashtu edhe në shtyp (66%).

Hyrje

Komisionet e të vërtetës janë shfaqur si adresa plotësuese të drejtësisë dhe pajtimit në vendet që janë përpjekur të kalojnë nga periudha e abuzimeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën, në një të ardhme të qëndrueshme dhe demokratike. Këto komisione janë organe zyrtare të krijuara zakonisht nga shtetet gjatë momenteve të ndryshimit të regjimit për të hetuar dhe raportuar mbi modelet e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Këto organe nuk zgjidhin vetëm fakte specifike, por synojnë edhe të ndikojnë në mirëkuptimin shoqëror dhe pranimin e të kaluarës së një vendi. Në fakt, shumë komisione të të vërtetës kanë qëllimin e qartë për të nxitur pajtimin kombëtar i cili mund të kuptohet gjerësisht si proces që e pranon të kaluarën dhe riparon marrëdhëniet që ajo ka shkatërruar. Sidoqoftë, pajtimi duhet të kuptohet si proces shoqëror afatgjatë që nuk mund të arrihet vetëm nga një komision i të vërtetës. Në rastin më të mirë, komisionet mund të ndihmojnë për krijimin e kushteve më të mira për pajtim duke nxitur reformën institucionale dhe ndryshimet në kulturën politike të një shteti dhe duke rivendosur dinjitetin e atyre më të prekurve nga dhuna.

¹

Komisionet e të vërtetës janë më efektive kur përfshihen në një strategji gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale që përfshin politika dëmshpërblimi, ndjekje penale dhe reforma institucionale. Duke ofruar gjetje të qarta dhe rekomandime bindëse, komisionet mund të pasurojnë politikën dhe të krijojnë nxitje politike e morale për këto nisma.²

Në fund të viteve 1990, Komisioni i të Vërtetës dhe i Pajtimit i Afrikës së Jugut, i ngritur për t'u marrë me trashëgiminë e Aparteidit, solli konceptin e komisioneve të të vërtetës në qendër të vëmendjes ndërkombëtare. Por ka pasur shumë komisione të tjera të të vërtetës, nën emra të ndryshëm, para dhe pas, me nivele të ndryshme të 'suksesit'. Në vitet 1980, Argjentina ishte vendi i parë që mbajti me sukses një komision të të vërtetës, të quajtur Komisioni Kombëtar për Zhdukjen e Personave, për t'u marrë me krimet e kryera nga drejtuesit në largim të një diktature ushtarake të dhunshme. Raporti i komisionit, *Nunca Mas* ("Kurrë më") u bë i njohur në gjithë botën. Pas një dekade, Komisioni për Sqarim Historik i Guatemalës gjithashtu ia doli të tubojë, përpunojë dhe përmbledhë sasi të madhe informacioni të dorës së parë në një raport përfundimtar që paraqiti një dëshmi autoritative të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, komisioni u përball me sfida të rëndësishme si pasiguria financiare dhe kompetencat e pakta për hetime. Edhe Komisionit të Guatemalës iu ndalua që t'i emëronte disa individë të caktuar përgjegjës për dhunën në raportin përfundimtar, ndërsa Komisioni më i fundit i Barazisë dhe Pajtimit në Marok u lejua të krijonte përgjegjësi institucionale dhe jo individuale për të ligat e kryera gjatë një periudhe 43-vjeçare.³

Në përgjithësi, komisionet e të vërtetës mund të kontribuojnë shumë në shoqëri duke krijuar dosje zyrtare të abuzimeve të të drejtave të njeriut të kryera në të kaluarën, duke identifikuar faktorët që kanë nxitur dhunën dhe duke hapur rrugën që viktimat të shërohen dhe ish-luftëtarët të riintegrohen

¹ González, E. & Howard Varney (eds.), 'Truth Seeking: Elements of Creating an Effective truth Commission', ICTJ, 2013, <https://ictj.org/sites/default/files/ICTJ-Book-Truth-Seeking-Chapter2-2013-English.pdf>

² po aty

³ <https://library.cqpress.com/cqresearcher/document.php?id=cqrglobal2010010000>

në shoqëri, duke siguruar hapësirë të sigurt për dëshmitë. Sidoqoftë, ata mund të kritikohen lidhur me “të vërtetën” e kujt e thonë, pasi gjetjet e tyre mbi modelet e shkeljeve dhe të përgjegjësisë mund të sfidojnë narrativat e ndryshme shoqërore të të kaluarës.

Në vitin 2017, Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi inicioi idenë e krijimit të një Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë, që ta ndihmojë sigurimin e bazës për dialog midis komuniteteve të ndara të Kosovës. Në thelb, një KVP i tillë duhet të synojë të vendosë faktet mbi luftën e fundit të Kosovës, të mbrojë viktimat dhe të mbijetuarit dhe t'i informojë ndryshimet e politikave në Kosovë. Pas disa konsultimeve me aktorët kryesorë të politikave, viktimat dhe familjet e personave të zhdukur, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë, Presidenti, në përputhje me nenin 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të ligjit nr. 03 / L-094, dhe në përputhje me nenin 3 (4) të Rregullores (P) Nr 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (8.9.2016), dhe Vendimin Nr. 51/2017 nxori një vendim për caktimin e Ekipit Përgatitor për krijimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (Protokolli Nr. 892-01.11.2017).⁴ Ky ekip përbëhet prej individësh nga qeveria dhe shoqëria civile, si dhe ekspertë të pavarur⁵ dhe është mandatuar të përgatisë dokumentacionin për krijimin e KVP.

Ekipi Përgatitor (PT) filloi punën e tij në maj të vitit 2018 dhe deri më tani ka përpiluar një draft Akti Normativ që përshkruan objektivat, mandatin dhe funksionet e KVP-së së ardhshme. Akti rikujton se populli i Kosovës ka vuajtur kohë të gjatë pasojat e një të kaluarë të dhunshme dhe prandaj duhet ta fillojë një proces shërimi duke kërkuar të vërtetën, duke kuptuar që viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë të drejtë ta dinë të vërtetën dhe të drejtën e duhur të kompensimit për vuajtjet që kanë pësuar. Ky proces do t'u hapë rrugën brezave të ardhshëm që të ndërtojnë dhe mbajnë një paqe të qëndrueshme.

Ky studim synon të gjejë një kuptim specifik kosovar, dhe ka nevojë për pajtimin dhe konceptet e ndërlidhura të të vërtetës, drejtësisë dhe dokumentimit lidhur me konfliktin e fundit të viteve 1998-99 në Kosovë. Veç kësaj, u vlerësua të kuptuarit dhe përkrahja për krijimin e një Komisioni për të Vërtetën dhe të Pajtimin (KVP) në Kosovë.

Hulumtimi i kryer më parë sugjeron se konceptet e të vërtetës, pajtimit dhe mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, si komisionet e të vërtetës, janë kuptuar në mënyra të ndryshme nga grupe të ndryshme në Kosovë.⁶ Për këtë studim, studiuesit duhet të sigurojnë informacione fillestare

⁴ https://www.president-ks.gov.net/repository/docs/2019_10_16_125802_DECISION_ON_THE_APPOINTMENT_OF_THE_PREPARATORY_TEAM_15102019.pdf

⁵ po aty

⁶ Adamović, Mirjana, Anja Gvozdanović & Marko Kovačić, *Process of Reconciliation in the Western Balkans and Turkey: A Qualitative Study*, Zagreb 2016 (part of the Divided Past - Joint Future project); Ahmetaj, Nora & Thomas Unger, 'Kosovo's Framework for Dealing With the Past at a Turning Point: Civil society review of progress towards a National Strategy on Transitional Justice', April 2017 <http://kosovomemory.org/wp-content/uploads/2018/10/Civil-society-review-of-progress-toward-a-National-Strategy-on-Transitional-Justice.pdf>; Ahmetaj, Nora, 'Deconstructing Reconciliation in Kosovo', Centre for Research, Documentation and Publication, June 2017

konceptuale, për t'iu dhënë mundësi të anketuarve /pjesëmarrësve në diskutimin brenda GF që të shprehin mendimet fillestare për të vërtetën(-at) lidhur me konfliktin e fundit në Kosovë, dhe për nevojën e krijimit të KVP-së. Procesi i krijimit të KVP ngre një varg pyetjesh bazë në mesin e të anketuarve lidhur me narrativat nga e kaluara, pranimin e saj me pëlqimin e elitës dhe të shoqërisë nga të gjitha grupet e interesit dhe bashkësitë.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të përmbledhë një studim përfaqësues mbi perceptimin e publikut lidhur me Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP), duke përfshirë të paktën 1065 të anketuar, rezultatet e të cilëve u analizuan më tej nga diskutimet e grupeve të fokusit njëetnike.

Metodologjia

Hulumtimi adoptoi një metodë të metodave të përziera, duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjes që trajton, për ta shtuar vlefshmërinë dhe thellësinë. Ai përbëhet nga një studim kuantitativ i ndjekur nga një kualitativ me gjashtë grupe të fokusit (tre me shqiptarë dhe tre me serbë dhe pakicat e tjera) me qëllim të testimit të hipotezës me të anketuarit rreth koncepteve të të vërtetës, pajtimit dhe themelimit të KVP.

Hulumtimi kuantitativ

Anketa është kryer duke përdorë metodën e marrjes së mostrave rastësore, me 1065 individë të zgjedhur rastësisht në të gjitha 38 komunat e Kosovës. Kjo mostër është llogaritur duke marrë parasysh nivelin e mirëbesimit prej 95% dhe një diferencë gabimi prej 3% për të gjithë mostrën, si dhe është përfaqësuese e popullatës së synuar. Anketa u krye midis përfaqësuesve të shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe pakicave të tjera të Kosovës (boshnjakë, romë, turq dhe goranë), 18 vjeç e më të vjetër, njëlloj në zonat urbane dhe rurale. Mostra e përgjithshme prej 1065 vetash u nda në tri nënmostra bazuar në grupet etnike që jetojnë në Kosovë: Komuniteti shqiptar, serb dhe komunitete të tjera joshumicë të përmledhura në këtë studim si 'K-Të tjerët'. Nënmostrat e serbëve dhe të K-të tjerëve u ekzaminuan në mënyrë që të lejonin një analizë indikative të rezultateve të zbërthyera sipas grupit etnik. Më poshtë, tregohet shpërndarja e intervistave për të tri nën-mostrat:

Etnia	Numri i intervistave
K-Shqiptarët	818 (77%)
K-Serbët	150 (14%)
K-të tjerët	97 (9%)

Duke marrë parasysh që etnitë serbe dhe etnitë tjera ishin të mbizgjedhura, peshat e mostrave u konstruktuan për t'iu përshtatur kësaj mbizgjedhjeje, ashtu që rezultatet e përgjithshme të pasqyrojnë strukturën e popullsisë së Kosovës që përbëhet nga 92% shqiptarë, 4% serbë dhe 4% të tjerë.⁷ Këto peshime janë përdorë gjatë gjithë analizës së rezultateve sa herë i referohemi tërë popullatës së të rriturve të Kosovës.

Pyetësi u administrua përmes intervistave sy më sy, duke përdorur teknikën e intervistimit personal të ndihmuar nga kompjuteri (IPNK). Teknika IPNK siguron më pak gabime dhe cilësi

⁷ ASK, Regjistrimi 2011

më të lartë të të dhënave, duke siguruar vlefshmërinë e studimit. Ekipi i punës në terren përbëhej nga 23 regjistruar të përzgjedhur me kujdes, dy mbikëqyrës në terren, një kontrollues teknik dhe një koordinator terreni. I gjithë ekipi që trajnuar për t'u siguruar që regjistruar të kuptonin plotësisht pyetjet e anketës, të njihnin metodologjinë e marrjes së mostrave dhe të intervistimit dhe të ishin në gjendje të administronin intervistat me lehtësi, saktësi dhe konsistencë.

Para hulumtimit në terren u krye një testim pilot i pyetësorëve për t'i vërtetuar sa i përket përmbajtjes dhe logjikës. Testi pilot mundësoi edhe përcaktimin e besueshmërinë së pyetësorëve, si dhe matjen e kohës së nevojshme për përfundimin me sukses të një interviste. Pastaj u bënë modifikimet e nevojshme dhe u pasqyruan në të dy gjuhët në të cilat u zhvillua pyetësi: shqip dhe serbisht.⁸

Puna në terren e anketës u krye ndërmjet 24 shtatorit dhe 15 tetorit 2019.

Në vija të trasha, pyetjet e përfshira në pyetësor mund të grupohen në tri fusha: demografia, perceptimi i qytetarëve për të vërtetën dhe pajtimin, si dhe pikëpamjet e tyre për Komisionin e të Vërtetës dhe të Pajtimit për Kosovën.

Hulumtimi kualitativ

Në pjesën e dytë të studimit u realizua një hulumtim kualitativ me gjashtë grupe fokusi të mbajtura në Prishtinë, tri me shqiptarë dhe tri me serbë dhe të tjerë (turq, romë, goranë, boshnjakë) - me gjithsej 87 pjesëmarrës nga grupe të ndryshme. Grupet e fokusit përbëheshin nga 12 deri në 15 individë, të moshave nga 20 deri në 60 vjeç, me një përfaqësim gjinor me raport 50/50 dhe diversitet në profile duke përfshirë: gazetarë, historianë, mësues, anëtarë të shoqatave të viktimave civile dhe të personave të zhdukur, artistë, komunitetin akademik dhe fetar, punonjësit publikë, aktivistët e OJQ-ve, pensiontët, të papunët, dhe punonjësit e pavarur.

Pyetjet u krijuan për të mbushur boshllëqet e identifikuar nga rezultatet e sondazhit kuantitativ dhe u prezantuan pjesëmarrësve për të marrë inputet e tyre mbi çështjet e pajtimit dhe mandatin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. Diskutimet në grupe fokusi u regjistruan, u transkriptuan dhe u rishikuan nga studiuesit.

⁸ Një përkthim në anglisht është përgatitur për shqyrtim nga ekspertët e jashtëm.

Rezultatet e hulumtimit

Profili demografik i të anketuarve

Nga 1065 të anketuar, 52% ishin burra dhe 48% gra, që kryesisht i përkisnin grupmoshës 25 – 34 vjeç (25%), pasuar nga grupmosha 18 – 24 vjeç (19%). Për më tej, 45% e të anketuarve kanë mbaruar shkollën e mesme 4-vjeçare dhe 31% janë të punësuar me orar të plotë. Pakëz më shumë të anketuar vijnë nga zonat rurale (53%) sesa ato urbane (47%). Mes të anketuarve, 53% i përkasin njërit prej grupeve të vendosura me ligj që lidhen me përvojën e kohës së luftës. Kjo tregon se një përqindje e madhe e popullsisë është prekur nga konflikti i fundit.




Figura 1. A i përkisni ndonjëres prej këtyre kategorive të krijuara me ligj?

Pikëpamje mbi të vërtetën, pajtimin dhe aktorët kryesorë

Për të filluar, ishte me rëndësi të vlerësoheshin mendimet e të anketuarve mbi ndryshimet që kanë vërejtur qysh nga fundi i konfliktit të armatosur në Kosovë më 1999; shiko Figurën 2. Tri fusha, të cilat të anketuarit besojnë se kanë përmirësime, janë: infrastruktura (74%), lëvizshmëria (69%) dhe barazia gjinore (60%). Ndërsa, 58% e të anketuarve janë të mendimit se arsimi është përmirësuar. Sa i përket punësimit, mendimet ndahen; 36% e të anketuarve mendojnë se situata e punësimit është përmirësuar, kurse 34% mendojnë se është përkeqësuar. Lidhur me Kujtimin dhe Memorializimin, 39% mendojnë se ka marrë më shumë vëmendje, ndërsa 37% nuk kanë parë ndonjë ndryshim në këtë fushë.

Mbi gjysma e të anketuarve (54%) shqetësohen për nivelin e korrupsionit, i cili sipas tyre është përkeqësuar që nga përfundimi i luftës. Me vetëm 17% të të anketuarve që mendojnë se korrupsioni është zvogëluar, ai mbetet çështje serioze për qytetarët.




Figura 2. Si e vlerësoni ndryshimin në fushat vijuese që nga përfundimi i luftës?

Figura 3 tregon pikëpamjet e të anketuarve për ndryshimet në fushat e sigurisë, marrëdhënieve etnike, të drejtave civile e politike, ekonomisë, pabarazisë, sigurisë shoqërore dhe drejtësisë që nga përfundimi i luftës. Ndonëse më shumë se gjysma e të anketuarve të intervistuar (59%) mendojnë se siguria e tyre është përmirësuar, vetëm 38% mendojnë se sistemi i drejtësisë është përmirësuar.




Figura 3. Si e vlerësoni ndryshimin në fushat vijuese që nga përfundimi i luftës?

E drejta për të vërtetën si shtylla e parë e Drejtësisë Tranzicionale si proces pohon se viktimat e shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe anëtarët e familjes së tyre kanë të drejtë të dinë të vërtetën për identitetin e autorëve, shkaqet që i bënë ata të vuajnë, dhe fatin ose vendndodhjen e të pagjeturve. Në fund të fundit, ata kanë të drejtat e tyre të garantuara nga konventat vendase dhe ndërkombëtare për të kërkuar drejtësi. Siç tregon figura 4 më poshtë, kjo e drejtë duket të jetë e panjohur për shumicën e qytetarëve. Afro 62% e të anketuarve kurrë nuk kanë dëgjuar për të, ndërsa 25% po, kurse 13% nuk janë të sigurt për këtë temë. Për këtë arsye dhe para se të vazhdojnë me pyetje të tjera që kanë të bëjnë me drejtësinë tranzicionale dhe Komisionin për të Vërtetën dhe të Pajtimin, të anketuarve iu dha informacion shtesë për të drejtën e të vërtetës.

■ Po ■ Jo ■ Nuk jam i/e sigurt




Figura 4. A keni dëgjuar ndonjëherë për të drejtën për të vërtetën?

Për sa i përket mendimit të tyre mbi rëndësinë që viktimat dhe familjet e tyre ta dinë të vërtetën për të kaluarën (shiko fig. 5), 80% e të anketuarve besonin se kjo ishte shumë e rëndësishme, ndërsa vetëm 8% e të anketuarve ishin neutralë ose nuk mendonin se ishte e rëndësishme.




Figura 5. A mendoni se është e rëndësishme që viktimat dhe familjet e tyre ta dinë të vërtetën?

Nga grupi i vogël i të anketuarve (2% ose n=21) që thanë se ka pak rëndësi që viktimat dhe familjet e tyre ta dinë të vërtetën, më shumë se gjysma (59%) shpjeguan se mendojnë që gjetja e të vërtetës nuk ka ndikim, kurse të tjerët (33%) nuk dhanë shpjegime të mëtejme. Vetëm 8% e tyre vërtet besojnë se lufta i dëmtoi kosovarët përtej riparimit dhe për këtë arsye e vërteta nuk është e rëndësishme (shiko figurën 6).




Figura 6. Pse mendoni se nuk është e rëndësishme?

Në GF ku pjesëmarrësit kishin më shumë hapësirë të diskutonin dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve, disa pjesëmarrës serbë konceptuan të vërtetën si një proces të nevojshëm për t'u marrë me trashëgiminë e të kaluarës së fundit në Kosovë:

"Momenti kur them, është e vërtetë, ne ta kemi vrarë vëllain, në atë moment, mund të fillojë pajtimi. E vërteta duhet të dalë dhe me zë të lartë, por nga njerëzit". (Pjesëmarrës serb i Kosovës)

"E vërteta është kur e njoftoni palën tjetër pse disa krime janë kryer në vitet 1990... Mendoj se e vërteta është një lloj të rrëfyeri nga të dyja palët për krimet e kryera në të kaluarën, kur faji pranohet, dhe kjo duhet të çojë në pajtim." (Pjesëmarrës serb i Kosovës)

Edhe midis pjesëmarrësve në GF të shqiptarëve, u njoh nevoja për fakte dhe të vërtetën për të gjitha palët:

"Pavarësisht se në çfarë periudhe kohore, çdo vrasje që është kryer meriton trajtim të barabartë, kushdo që ta ketë kryer. Ideja është që nëse kërkojmë drejtësi, duhet të hetojmë dhe t'i interpretojmë faktet në arenën ndërkombëtare, por kur e bëjmë këtë, unë mendoj se sa më shumë aq më mirë, sepse tash po hyjmë në dekadën e tretë pas luftës, e me kalimin e viteve, dëshmitarët janë potencialisht të vdekur, prandaj mbledhja e fakteve bëhet problem". (Pjesëmarrës shqiptar i Kosovës)

Shqetësimi për mungesën e provave ose të të dhënave të ruajtura u përmend nga disa pjesëmarrës:

"Unë mendoj se nuk ka prova të mjaftueshme... Dua të nënvizoj faktin se një mik ishte në Agjencinë e Statistikave të Kosovës para disa ditësh dhe po kërkonte numrin e shtëpive të djegura gjatë luftës por nuk gjeti të dhëna të tilla... Mendoj se të dhënat nuk janë të sakta as për të zhdukurit, as për gratë e abuzuara seksualisht në luftë, e vërtet na duhen jo vetëm për t'i shëruar plagët e të kaluarës, por ndoshta për të kërkuar drejtësi... " (Pjesëmarrës shqiptar i Kosovës)

Për sa i përket rëndësisë, pa marrë parasysh ç'do të zbulojë e vërteta, një shumicë e madhe e të anketuarve mendojnë se e vërteta është e rëndësishme edhe kur zbulon identitetin e autorëve (91%), informata të ndryshme nga ato që kanë dëgjuar/lexuar deri tani (90%), ose diçka të pafavorshme për personat që kanë mbështetjen e tyre politike (86%). E vërteta vlerësohet si e rëndësishme edhe kur zbulon diçka të pafavorshme për qytetin ose rajonin e dikujt (86%), bashkësinë etnike (84%) ose identitetin fetar (83%).




Figura 7. A mendoni se e drejta për të vërtetën është e rëndësishme edhe nëse...:

Pikëpamje për pajtimin

Të anketuarit mund të zgjidhnin më shumë se një përgjigje për të përcaktuar ç'nënkuptonte pajtimi për ta (shih Figurën 8). Kuptimet e pajtimit të zgjedhura nga të paktën tri të katërtat e të anketuarve ishin: paqja (e përcaktuar si ulje e dhunës); respektimi i të drejtave individuale të njeriut; bashkëjetesa etnike; e vërteta për të kaluarën; dialogu; kriminelët e dikurshëm të marrin përgjegjësi dhe të kërkojnë falje (duke bërë ndryshime); dy palë që bëjnë një kompromis; vënia e kriminelëve para përgjegjësisë; dhe përmirësimi i marrëdhënieve midis palëve të dikurshme konfliktuale.

Në të njëjtën kohë, mbi gjysma e të anketuarve (55%) u përgjigjën se pajtimi do të thotë të mos bësh asgjë për të kaluarën dhe në vend të kësaj të përqëndrohesh në të ardhmen, ndërsa 45% e lidhnin pajtimin me faljen e kriminelëve të të kaluarës. Për një të tretën e të anketuarve (33%) pajtimi dhe marrja me të kaluarën nuk kanë aspak kuptim, që është mjaft domethënëse.



Figura 8. Çka do të thotë për ju "pajtim" kur mendoni të merreni me të kaluarën në Kosovë?

Sidoqoftë, diskutimet e grupeve të fokusit dhanë përgjigje pak më specifike dhe më të qarta për diskursin e pajtimit. Ndonëse edhe shqiptarët edhe joshqiptarët e shohin pajtimin si proces të vazhdueshëm pas përfundimit të një vargu aktiviteteve të mëparshme, aktivitetet e propozuara nga të anketuarit shqiptarë ndryshojnë nga ato të propozuara nga serbët. Pjesëmarrësit shqiptarë mendojnë se një proces pajtimi duhet të paraprihet nga gjetja e personave të zhdukur, dhe e shohin edhe kërkimin e faljes dhënë viktimave nga autoritetet serbe si parakusht. Sipas tyre, kjo do të sillte të paktën një nivel të caktuar satisfaksioni për viktimat dhe të afërmit e tyre.

“Nuk besoj se ka kush në Kosovë që të thotë se do t'i falë kriminelët. Ky është parim i drejtësisë. Kushdo që ka bërë krime, duhet të burgoset. Këtu na mungon sistemi i drejtësisë dhe ajo nuk ka qenë efikase. Drejtësia zakonisht çon në pajtim, nëse do të kishte më shumë kriminelë të dënuar, jam i sigurt se njerëzit do të ishin të kënaqur”. (Pjesëmarrës shqiptar i Kosovës)

Edhe pjesëmarrësit serbë e shoqërojnë ndëshkimin e krimeve të luftës si parakusht të rëndësishëm për pajtimin. Një prej tyre komentoi:

"Por çështja nuk është vetëm te falja, por te ndëshkimi. Pa ndëshkim, falja nuk ka kuptim. Përkundrazi, është shërbimi më i madh. Sepse krijon kushtet për kryerjen e krimeve të reja në të ardhmen. Sepse asnjë krim i të kaluarës nuk u ndëshkua'.

Për më tej, për serbët e Kosovës pajtimi ka edhe një përmasë të ardhshme në kuptimin e normalizimit të marrëdhënieve midis dy palëve;

"Paj, për mua pajtimi është normalizim i marrëdhënieve midis serbëve dhe shqiptarëve, për të cilin duhet punuar për shumë vjet që vijnë" (pjesëmarrës serb i Kosovës)

Për më shumë, edhe pjesëmarrësit shqiptarë edhe ata serbë në GF besojnë se pajtimi duhet të arrihet në nivelin institucional, përmes një marrëveshjeje midis qeverive të Serbisë dhe të Kosovës dhe njohjes së tyre të ndërsjellë, ku të dyja e ndihmojnë para se ta pengojnë procesin e pajtimit midis bashkësive etnike në Kosovë. Pjesëmarrësit pohuan se të gjitha grupet etnike në Kosovë duhet të pranojnë atë që ndodhi dhe të punojnë në nivelin lokal së pari, dhe se e kaluara duhet të shërbejë për ndërtimin e së ardhmes.

"Një hap drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës çon në pajtim, por unë së pari do ta bëja këtë pajtim në nivel lokal, sepse kemi parë deri tash se nuk ka pasur sukses në nivelin qendror" (pjesëmarrës serb i Kosovës).

Në anketë, të anketuarit mund të jepnin përgjigje të shumta se mes kujt duhej të bëhej pajtimi. Më se gjysma e të anketuarve (63%) besojnë që pajtimi duhet të arrihet nga të dyja qeveritë - ajo e Kosovës dhe e Serbisë si dy shtete.




Figura 9. Sipas mendimit tuaj, pajtimi duhet të bëhet ndërmjet: (sipas etnisë)

Të zbërthyer sipas grupit etnik, kjo pikëpamje mbështetet kryesisht nga shqiptarët (64%) dhe të anketuarit e pakicave joserbe (71%), dhe veç pak mbi një e treta e serbëve (39%) kanë këtë mendim. Krahasimisht, pak më pak se gjysma e të gjithë të anketuarve (46%) favorizojnë përfshirjen e komuniteteve në arritjen e pajtimit; mes tyre 63% e serbëve kanë këtë mendim. 40% e të anketuarve besojnë se pajtimi duhet bërë midis viktimave dhe kryesve të krimeve.

Për më tej, sa i përket rëndësisë së përkrahjes nga aktorë të caktuar për arritjen e pajtimit, institucionet shtetërore dhe bashkësia ndërkombëtare shihen si shumë të rëndësishme nga shumica e të anketuarve (përkatësisht 82% dhe 79%). Megjithëse, shoqëria civile, media dhe sektori privat konsiderohen gjithashtu të rëndësishme nga shumica e të anketuarve. (shiko fig. 10).




Figura 10. Sa të rëndësishme e shihni përkrahjen këtyre akterëve dhe iniciativave për arritjen e pajtimit në Kosovë?

Të anketuarit u pyetën gjithashtu lidhur me rëndësinë e të vërtetës si parakusht për pajtimin. 90% e të anketuarve treguan se plotësisht ose pjesërisht pajtoheshin se e vërteta ishte relevante për pajtimin (shiko Figurën 11). Kjo sugjeron se shumica e të anketuarve janë të vetëdijshëm që një e vërtetë e mirëdokumentuar nevojitet të njihet nga të dyja palët që të arrihet pajtimi. Sidoqoftë, ka mendime të ndryshme se si të gjindet e vërteta. Një shumicë dërrmuese e të anketuarve (86%) plotësisht ose pjesërisht pajtohen që qytetarët e Kosovës posedojnë informata të mjaftueshme mbi faktet dhe të vërtetat e të kaluarës në lidhje me konfliktin '98/'99. Ngjashëm, 73% plotësisht ose pjesërisht pajtohen se institucionet e Kosovës ofrojnë baza të mira për të bërë pajtimin.




Figura 11. Ju lutemi na tregoni nëse pajtoheni ose jo me deklaratat vijuese?

Tabela e mëposhtme (Tabela 1) përshkruan pikëpamjet e të anketuarve nga çdo etni në lidhje me deklaratat e përmendura më lart. Ndërsa 75% e shqiptarëve dhe 74% e të tjerëve plotësisht ose pjesërisht pajtohen se institucionet shtetërore të Kosovës ofrojnë baza të mira për pajtim, vetëm 23% përqind e serbëve mbështesin një mendim të tillë.

Tabela 1. Ju lutemi na tregoni nëse pajtoheni ose jo me deklaratat e mëposhtme? Sipas etnisë

	Shqiptarët			Serbët			Të tjerët		
	Pajtohem	Neutral	Nuk pajtohem	Pajtohem	Neutral	Nuk pajtohem	Pajtohem	Neutral	Nuk pajtohem
Besoj se institucionet shtetërore të Kosovës të përfshira në pajtim ofrojnë baza të mira për ta arritur pajtimin	75%	12%	13%	23%	9%	68%	74%	20%	6%
Besoj se shoqëria civile e përfshirë në pajtim ofron baza të mira për ta arritur pajtimin	79%	12%	9%	32%	25%	43%	71%	23%	6%
Besoj se media ofron baza të mira për ta arritur pajtimin	77%	13%	11%	34%	20%	45%	67%	28%	5%
Drejtësia ligjore është e nevojshme për pajtimin	90%	7%	3%	68%	13%	19%	72%	23%	5%

Pajtimi është dytësor ndaj problemeve ekonomike	79%	10%	10%	38%	32%	30%	65%	25%	10%
Zbulimi i të vërtetës është i domosdoshëm për pajtimin	92%	6%	2%	63%	14%	24%	80%	18%	2%
Si shoqëri, tashmë i dimë të gjitha faktet dhe të vërtetat e asaj që ndodhi gjatë luftës dhe pas saj	87%	7%	6%	65%	22%	13%	71%	23%	6%

Në diskutimet e GF nuk u bashkënda besimi në aftësitë e institucioneve vendore të synuara për pajtim. Pjesëmarrësit në GF ishin shumë më skeptikë lidhur me arritjen e pajtimit përtej komunikimit individual. Pjesëmarrësit u pajtuan se pajtimi është çështje komplekse, që kërkon ndryshime thelbësore brenda komuniteteve dhe nëpër to. Për shkak të mungesës së besimit në institucionet dhe udhëheqësit politikë, si dhe mosbesimit midis komuniteteve, ata besojnë se pajtimi, përtej nivelit individual, vështirë do të arrihet në vitet e ardhshme.

Shumë nga pjesëmarrësit serbë në GF folën për marrëdhëniet private me shqiptarët si miq, bashkëpunëtorë, të njohur, etj., duke e shënuar këtë si tregues se pajtimi është i mundshëm. Sidoqoftë, pasi biseda u zhvillua më thellë tek e vërteta dhe pajtimi, kishte më shumë referenca "ne" kundrejt "atyre", duke nënvizuar dallimet në të kuptuarit e të kaluarës dhe të tashmes, si dhe vështirësitë në tejkalimin e saj. Pajtimi duket të jetë më i pranueshëm në nivel individual, sesa grupor.

"Nga ana tjetër, a mendoni vërtet se, nëse e quajmë ashtu, shoqëria kosovare, ose duhet të them shqiptarët si popull... A mendoni se ata janë kombëtarisht, kolektivisht, në nivel të tillë të vetëdijes si komb që të përballen me krimet e tyre?" ((Pjesëmarrës serb i Kosovës)

Njohuri mbi Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin

Për të testuar njohuritë e përgjithshme të të anketuarve në lidhje me Komisionet për të Vërtetën dhe Pajtimin në përgjithësi dhe iniciativën për themelimin e KVP-së në Kosovë në veçanti, ishte e nevojshme të shtroheshin disa pyetje themelore për një institucion të tillë.




Figura 12. A keni dëgjuar ndonjëherë për idenë e themelimit të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë?

Të anketuarve që thanë se kanë dëgjuar për KVP në Kosovë (14% në fig.12), iu kërkuar më tej të shkëmbejnë nivelin e tyre të njohurive për KVP-në (Figura 13). Gati gjysma e tyre (49%) thanë se dinë deri diku për KVP-në, dhe vetëm 10% se dinë shumë rreth saj. 41% të tjerë raportuan se nuk dinin asgjë ose jo aq shumë për të.




Figura 13. Sa do të thoshit se dini për KVP?

Pikëpamje drejt Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin

Për t'u futur më tej në bindjet dhe mendimet e të anketuarve për KVP dhe për të vlerësuar pikëpamjet e tyre për themelimin e saj, një përshkrim i përgjithshëm iu dha secilit të anketuar, që t'u jepej një ide mbi rolin dhe mandatin e KVP-së.⁹ Në këtë dritë, 76% e të anketuarve u ndien pozitivisht për krijimin e KVP-së në Kosovë. Vetëm 13% e të anketuarve ishin neutralë për

⁹ Teksti që iu lexua të anketuarve është ky: "Komisionet e të vërtetës janë organe zyrtare jogjyqësore me një kohëzgjatje të kufizuar që krijohen për të përcaktuar faktet, shkaqet dhe pasojat e shkeljeve të kaluara të të drejtave të njeriut. Ato i kushtojnë vëmendje të veçantë dëshmimeve, u ofrojnë njohje viktimave. Në vitin 2017 Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi inicioi krijimin e një Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin, i cili synon të ofrojë bazën për dialog midis bashkësive të ndara të Kosovës. KVP synon të përcaktojë fakte, të mbrojë viktimat dhe të mbijetuarit që lidhen me luftën e fundit të Kosovës dhe t'i informojë ndryshimet e politikave në Kosovë. Aktualisht ekziston një ekip përgatitor që punon në krijimin e KVP-së dhe ligji që e shoqëron se është duke u hartuar. Prandaj, kontributi dhe pikëpamjet tuaja si qytetarë janë shumë të rëndësishme në këtë proces."

krijimin e KVP-së, ndërsa 3% mendonin negativisht. Zbërthyer etnikisht, 79% e shqiptarëve dhe 60% e të tjerëve u shprehën pozitivisht për idenë e krijimit të KVP, ndërsa vetëm 29% e serbëve ishin pozitivë (shiko figurën 14). Njëkohësisht, një pjesë thelbësore e të anketuarve serbë ishin ose neutralë (29%) ose nuk dinin çka të mendonin për KVP-në (21%).




Figura 14. Në dritën e këtij informacioni, si ndjeheni për krijimin e KVP-së? Sipas etnisë

Përqindje të ngjashme u gjetën për përkrahjen faktike për krijimin e KVP (shiko Figurën 15). Në përgjithësi, 72% e të anketuarve në parim e përkrahën themelimin e KVP në krahasim me vetëm 3% që konfirmuan të kundërtën. Një në katër të anketuar thanë se nuk ishin të sigurt nëse e përkrahin ose jo. Të zbërthyer sipas entisë, të anketuarit shqiptarë janë më favorizues ndaj tij (76%) sesa joshqiptarët (28% të serbëve dhe 51% të të tjerëve). Hamendësimi kundrejt përkrahjes së KVP ishte më i lartë tek joshqiptarët (serbët 53% dhe të tjerët 47% përkatësisht).




Figura 15. Në parim, a e mbështetni krijimin e KVP-së? Sipas etnisë

Për më shumë, të anketuarve iu kërkua të rendisnin arsyet e përkrahjes kundrejt mospërkrahjes së krijimit të KVP-së (Figura 16). Nga përkrahësit, 39% pohojnë se KVP-ja do të shërbejë si mënyrë për të zbuluar të vërtetën, pasuar nga 16% që mendojnë se KVP do të jetë instrument që do ta sjellë drejtësinë për të gjithë duke vendosur masa ndëshkuese (dënimi i kryesve të krimeve). Çuditërisht, 12% duket se nuk kanë mendim pse e përkrahin ose jo. Ndërsa 11% u përgjigjën se arsyet e tyre kryesore për ta përkrahur KVP-në janë që të kontribuojë në gjetjen e vendndodhjes së personave të zhdukur nga konflikti i fundit.

Në mesin e atyre që nuk e përkrahin KVP-në, 33% nuk dhanë arsye pse jo. 26% të tjerë besojnë se një Komision i tillë nuk do të ketë sukses, pasuar nga 21% që nuk e mbështesin idenë për shkak të faktit se nisma erdhi nga presidenti i Kosovës, Z. Hashim Thaçi. Atëherë, 12% e të anketuarve u përgjigjën se nuk e mbështesin KVP-në sepse nuk duan të falin autorët për krimet e kaluara. Në këtë dritë, duhet theksuar se në objektivat e përcaktuar në projekt statut¹⁰ të KVP-së që kosovarët aspirojnë ta themelojnë, viktimave nuk u kërkohet të bëjnë pazare me kryesit e krimeve; viktimat mund të japin deklaratë ose të flasin në seancë publike, dhe atyre nuk u kërkohet të falin. Prandaj, falja do të jetë vendimi i tyre personal.

Në diskutimet e GF-ve midis pjesëmarrësve shqiptarë, kërkimfalja nga shteti serb u theksua vazhdimisht si parakusht për pajtim:

"Dhe komisioni mund të themelohet vetëm kur Serbia zyrtarisht të kërkojë falje, dhe sigurisht ta pranojë përgjegjësinë për krimet në të kaluarën dhe t'i paguajë dëmshpërblimet". (Pjesëmarrës shqiptar i Kosovës)

¹⁰ Burim, draft-statuti




Figura 16. Cila është arsyeja kryesore për ta përkrahur KVP kundrejt arsyes kryesore për të mos e përkrahur?

Parapëlqimet për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë

Ky seksion përfshin preferencat e të anketuarve në lidhje me mandatin dhe funksionimin e KVP të Kosovës, si dhe rezultatet që KVP duhet t'i arrijë.

Sa i përket llojit të shkeljeve të të drejtave të njeriut që KVP duhet të mbulojë, të gjitha opsionet e ofruara (shiko Figurën 17) u pranuan nga një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve. Mbi gjysma e të anketuarve (66%) identifikuan vrasjet masive si shkelje për t'u hulumtuar nga KVP-ja, si dhe përdhunimet e dhunën seksuale (63%), burgimin e padrejtë (60%), torturat ose abuzimin (60%) dhe rrëmbimet (59%).




Figura 17. Cilat lloje të shkeljeve të të drejtave të njeriut duhet të mbulojë KVP?

Zbërthyer sipas etnive, mund të vërejmë dallime se cilat nga shkeljet e të drejtave të njeriut besojnë pjesëtarët e etnive të ndryshme se duhet t'i mbulojë KVP-ja (shiko Figurën 18). Shkeljet kryesore të pohuara nga shumica e shqiptarëve dhe të tjerët janë vrasjet masive (66% dhe 62%, përkatësisht), e cila u phoua nga një pjesë më e vogël e serbëve (47%). Nga ana tjetër, rrëmbimi ishte shkelja kryesore e zgjedhur nga serbët (50%). Shumica e shqiptarëve kanë përmendur shkelje të tjera si përdhunimi dhe dhuna seksuale (64%), burgimi i padrejtë (61%) dhe torturat e abuzimet (61%). Serbët përmendën zhvendosjen e detyruar (49%), vrasjet masive (47%) dhe dëbimet e detyruara (45%). Së fundi, shumica e të tjerëve mendojnë se KVP-ja duhet të mbulojë vrasjet masive (62%), burgosjet e padrejta, torturat dhe abuzimet, dhe zhdukjet e detyruara (52% për të trija).




Figura 18. Cilat lloje të shkeljeve të të drejtave të njeriut duhet të mbulojë KVP? Sipas etnisë

Sa i përket afatit të hetimit nga KVP, të anketuarit u pyetën se cilën periudhë mendojnë që KVP duhet ta përfshijë (shiko Figurën 19). Të anketuarit mund të zgjedhin vitin ose periudhën nga e cila KVP duhet të fillojë hulumtimin e saj, dhe vitin ose periudhën e mbarimit për hulumtimin e KVP-së. Nuk kishte kornizë kohore specifike për hetimet e KVP-së që të zgjidhet nga një shumicë e qartë e të anketuarve. Të anketuarit mund të jepnin përgjigje të hapura dhe Figura 19 tregon një varg mendimesh për këtë çështje, me 'majat' për afate të caktuara; 7,3% zgjedhën periudhën nga 1981 deri më 2000, pasuar nga 1999-2000 (6,4%), 1998-2019 (6,3%) dhe 1981- 1999 (4,8%).




Figura 19. Cilën periudhë mendoni se duhet ta mbulojë KVP? (Nga... deri...)

Të zbërthyer sipas etnisë, periudhat për t'u hetuar nga KVP-ja të zgjedhura kryesisht nga të anketuarit shqiptarë ishin 1981-2000 (7,3%), 1998-2019 (6,8%) dhe 1999-2000 (6,1%). Të anketuarit serbë kryesisht zgjedhën 1999-2019 (13,3%), 1998-2004 (10%) dhe 1999-2000 (8,7%).

Së fundi, të anketuarit e tjerë zgjedhën periudhën e viteve 1999-2019 (16,5%), pasuar nga 2000-2019 (15,5%) dhe 1981-2000 (10,3%). Shih Tabelën 2.

Tabela 2. Cilën periudhë mendoni se duhet ta mbulojë KVP? Nga... deri... (pyetje e hapur)

Tri periudhat më të zgjedhura					
K-Shqiptarët		K-Serbët		K-Të tjerët	
1981-2000	7,3%	1999-2019	13,3%	1999-2019	16,5%
1998-2019	6,8%	1998-2004	10%	2000-2019	15,5%
1999-2000	6,1%	1999-2000	8,7%	1981-2000	10,3%

Në kushtet e krijimit të KVP-së, të gjithë pjesëmarrësit e GF shprehen se lypset transparencë totale, ndërsa nga një GF në tjetrin kishte një larmi mendimesh mbi periudhën kohore në të cilën duhet të hetojë KVP. Për shembull, pjesëmarrësit shqiptarë preferonin që pikënisja e hulumtimit dhe hetimit nga KVP të ishte viti 1968¹¹ e deri në ditët e sotme, ose një periudhë nga 1981-1999 ose 1998-1999. Për pjesëmarrësit serbë nga ana tjetër, një periudhë e preferuar ishte nga 1998 deri në 2005.¹²

Figura 20 tregon përqindjen e të anketuarve që zgjedhën aktorë të ndryshëm për t'u hetuar nga KVP. Kur shikojmë të gjithë grupin e të anketuarve, 74% mendojnë se policia e serbëve duhet të hetohet, pasuar nga aktorë të dhunshëm joshitetërorë që nuk mund të konsiderohen agjentë qeveritarë ose paramilitarë (72%). Pranë këtyre, 69% e të anketuarve duan që të shqyrtohen Agjentët e Qeverisë Jugosllave, si dhe forcat e Armatës Popullore Jugosllave (APJ) (65%) dhe agjentët paramilitarë (64%). Vetëm 10% e të anketuarve kanë zgjedhur që UÇK-ja të shqyrtohet nga KVP.

Të zbërthyer sipas etnive, vetëm (7%) e serbëve besonin se policia e serbëve dhe agjentët e qeverisë jugosllave duhet të shqyrtohen në krahasim me 77% të shqiptarëve dhe 67% të pakicave

¹¹ Historia e lëvizjes studentore në Kosovë fillon me demonstratat e vitit 1968, kur profesorë e studentë të Universitetit të Prishtinës organizuan protestë paqësore për kthimin në mjediset shkollore. Shih: The Democratic Values of the Student Movement in Kosovo 1997/1999 and Their Echoes in Western Diplomacy Lulzim NIKA, 2018.

¹² Përfshirja e vitit 2005 ka gjasë se lidhet me trazirat e dhunshme më 17 dhe 18 mars 2004, nga shqiptarët në gjithë Kosovën, të nxitura nga raporte të bujshme dhe përfundimisht të pasakta se serbët kishin qenë përgjegjës për mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë. Për afro dyzet e tetë orë, strukturat e sigurisë në Kosovë (Forcat e KFOR-it të udhëhequra nga NATO-ja, policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi i Policisë së Kosovës (ShPK) me të rekrutuar vemdas, pothuajse plotësisht e humbën kontrollin, pasi të paktën tridhjetë e tri trazira të mëdha shpërthyen në gjithë Kosovën, duke përfshirë rreth 51,000 pjesëmarrës. Shih: Human Rights Watch, 'Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo', July 2004; <https://www.hrw.org/report/2004/07/25/failure-protect/anti-minority-violence-kosovo-march-2004>

të tjera joserbe. Për më tej, një pjesë e madhe e të anketuarve serbë (63%) pohuan se UÇK-ja duhet të shqyrtohet nga KVP, ndërsa vetëm 8% e shqiptarëve e mbështesin këtë mendim.

Është interesante se shifra e mëposhtme tregon që shqiptarët, serbët dhe pakicat e tjera joserbe shprehin qëndrime afërsisht të ngjashme lidhur me aktorët e dhunshëm joshтетërorë ose agjentët paramilitarë (me 73%, 62% dhe 53% përkatësisht).

Është e qartë se ka dallime të dukshme në opinione midis shqiptarëve dhe serbëve mbi çështjen se cila palë ka kryer shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe kush duhet të shqyrtohet e të mbahet përgjegjës për veprimet e kaluara. Ky hendek në perceptime është njëra nga arsyet se pse është i nevojshëm një komision i së vërtetës.




Figura 20. Cilët aktorë mendoni se duhet t'i shqyrtojë/studiojë KVP? Sipas etnisë

Të pyetur për rezultatet që KVP-ja duhet t'i arrijë (shiko Figurën 21) mund të zgjidhnin përgjigje të shumta. U përkrah shumë ideja që familjet e personave të zhdukur të njoftohen se çka ka ndodhë me të dashurit e tyre (69%), e pasuar ngushtë me ofrimin e informacionit dhe dhënien e rekomandimeve ashtu që fajtorët për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe krimet gjatë dhe pas luftës të mbahen përgjegjës (67%). Po ashtu, shumë veta mendojnë se KVP duhet të ofrojë një pasqyrë të vërtetë dhe të paanshme të luftës së fundit (62%). Mbi gjysma e të anketuarve kërkojnë edhe rekomandime të politikave nga KVP për të ndihmuar me parandalimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut në të ardhmen (60%) dhe rekomandimet për kompensimin e atyre që kanë pësuar abuzime të të drejtave të njeriut (56%). Përgjigjia më pak e zgjedhur nga të anketuarit ishte që KVP-ja duhet të rekomandojë ofrimin e zbutjes së dënimit ndaj kryesve të krimeve që vendosin të bashkëpunojnë me KVP (37%).




Figura 21. Cilat nga rezultatet e dhëna mendoni se duhet t'i arrijë KVP?

Të anketuarve iu bënë edhe pyetje për një seri pohimesh për KVP-në për të cilat duhej të përcaktoheshin nëse pajtoheshin, nuk pajtoheshin ose ndiheshin neutralë (Figura 22). Në përgjithësi, të anketuarit plotësisht ose pjesërisht pajtoheshin me të gjitha pohimet e dhëna. Një shumicë dërrmuese e të anketuarve (90%) mendojnë se një Komision për të Vërtetën dhe Pajtimin është i nevojshëm në Kosovë, që KVP duhet të jetë e paanshme dhe e pavarur dhe se duhet të ketë mekanizma mbrojtës për viktimat dhe dëshmitarët. Po ashtu, të anketuarit e shohin shumë të rëndësishme që KVP të ketë përkrahjen e publikut dhe të anëtarëve të Kuvendit të Kosovës (përkatesisht 91%). Pranë kësaj, 87% e të anketuarve pajtohen se tani është moment i mirë që të krijohet një KVP. Për më tej, të anketuarit përkrahin fuqimisht mekanizmat e mbikëqyrjes,

transparencën, konfidencialitetin (lidhur me informacionin e dëshmitarëve) dhe nevojën për përkrahje nga institucionet e Kosovës për rekomandimet e KVP-së (ligjërisht detyruese).




Figura 22. A pajtoheni apo jo me pohimet e lartpërmendura?

Më poshtë (Figura 23) jepen pikëpamjet e qytetarëve se sa e besueshme do t'u dukej KVP bazuar në mënyrën si do të themelohej. Themelimi me një akt legjislativ u parapëlqye nga dy të tretat

(66%) e të anketuarve dhe vetëm 4% besonin kjo do të nënkuptonte më pak besueshmëri për KVP-në. Mundësia që KVP të krijohet si rezultat i një procesi gjyqësor u përkrah nga 51%, dhe 11% e të anketuarve u shprehën se një proces i tillë nuk do ta ndihmonte besueshmërinë e KVP. Themelimi përmes një dekreti presidencial u parapëlqye më së paku (42%), dhe 15% e të anketuarve nënvizuan se kjo mundësi do t'ia zvogëlonte besueshmërinë KVP-së.




Figura 23. Për ju, a do të kishte KVP më shumë ose më pak besueshmëri nëse...

Kur të anketuarve iu kërkuar të ndanin mendimet në lidhje me subjektet që duhet të përfshihen në hartimin e aktit normativ për krijimin e KVP-së (shiko Figurën 24), 62% e tyre përkrahën idenë që Kuvendi të jetë përgjegjës. Një grup ekspertësh vendas ishte përgjigjja që dhanë 52% e të anketuarve, ndërsa bashkësia ndërkombëtare dhe shoqëria civile u pëlqyen nga 48% dhe 43% e të anketuarve. Opsioni më pak i parapëlqyer ishte Zyra e Presidentit, me vetëm 31% në favor.




Figura 24. Kush mendoni se duhet të përfshihet në hartimin e aktit normativ për themelimin e KVP?

Për më tej (shiko Figurën 25), shumica e të anketuarve u pajtuan që kuotat duhen përdorë për t'u siguruar se ekziston një përfaqësim adekuat i grave dhe pakicave etnike në mesin e atyre që zgjidhen si komisionerë të KVP-së. Më konkretisht, 84% e të anketuarve ishin pro kuotave për gratë dhe 77% mbështetën kuotat për pakicat etnike. Ndërsa vetëm 5% nuk u pajtuan me mbajtjen e kuotave për gratë, dhe 7% nuk u pajtuan me kuotat për pakicat etnike.




Figura 25. Në lidhje me komisionerët e KVP, a mendoni se duhet të ketë kuota për të siguruar përfaqësim adekuat të:

Kur të anketuarit u pyetën se kush duhet të zgjidhte komisionerët e KVP (shiko Figurën 26), më së shumti u zgjodh emërimi nga Parlamenti i Kosovës - ose i bërë në bazë të një liste të nominimeve nga një komision përzgjedhës i përbërë nga viktimat e luftës, OJQ-të, mediat dhe publiku në përgjithësi (45%), ose direkt nga Kuvendi (43%). Mundësitë që një organ i pavarur profesional ose bashkësia ndërkombëtare të marrin rolin e emërimit të komisionerëve të KVP, morën përkrahje për gati një të tretën (32%) e të anketuarve. Zyra e Presidentit ishte mundësi më pak e favorshme, me 32% që përkrahnin këtë zgjedhje nëse lista e nominimeve përgatitej nga një komitet përzgjedhës i përbërë nga viktimat, OJQ-të, mediat dhe Publiku i përgjithshëm, dhe vetëm 25% përkrahën emërimet e drejtpërdrejta nga Zyra e Presidentit.

Në diskutimet e GF, pjesëmarrësit serbë ishin pak skeptikë ndaj procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të KVP. Ata preferonin që anëtarët të zgjidheshin drejtpërdrejt nga pjesëtarët e komunitetit dhe të kishin anëtarë të shoqatave të viktimave në komision. U shprehën se donin që anëtarët e KVP-së të ishin të paanshëm edhe në aspektin shumetnik.

"Komisioni duhet të jetë i paanshëm me përfaqësimin e përzgjedhur drejtpërdrejt nga komunitetet, bashkë me përfaqësuesit e të zhdukurve dhe viktimave, dhe OShC-të" (parafrazuar nga disa pjesëmarrës serbë)




Figura 26. Kush mendon se duhet t'i zgjedhë komisionerët e KVP?

Figura 27 tregon se 61% e të anketuarve deklaruan që Parlamenti i Kosovës duhet të ketë pronësi dhe përgjegjësi për të siguruar pavarësi financiare për KVP. Opsionet e tjera ishin dukshëm më pak të pëlqyera; vetëm 15% pohuan se bashkësia ndërkombëtare duhet të kontribuojë, dhe vetëm 12% zgjedhën Zyrën e Presidentit.




Figura 27. Kush mendon se duhet të jetë përgjegjës për buxhetin e KVP?

Për më tej, kur u pyetën se kush duhet të monitorojë punën e KVP (shiko Figurën 28), shumica (64%) e të anketuarve zgjedhën sërish Kuvendin si organin më të besueshëm për ta marrë këtë përgjegjësi. Zgjedhja tjetër më e njohur ishte bashkësia ndërkombëtare (44%), e ndjekur nga shoqëria civile dhe media (36%). Zyra e Presidentit mori mbështetjen e vetëm një çereku (24%) prej të anketuarve. Vetëm 11% nga të anketuarit thanë se nuk duhet të ketë ndonjë monitorim.




Figura 28. Kush mendoni se duhet të monitorojë KVP-në?

Zakonisht është në mandatin e një KVP-je të botojë një raport përfundimtar me rekomandime në fund të punës së vet. Të anketuarve iu bënë pyetje në lidhje me këtë raport përfundimtar (shiko Figurën 29). Dy nga tre të anketuar (66%) pajtohen që i gjithë raporti të publikohet në internet dhe në letër. Shumë më pak të anketuar (27%) deklaruan se vetëm disa pjesë të raportit duhet të publikohen dhe të vihen në dispozicion të publikut të gjerë në internet, ndërsa vetëm 6% preferuan që raporti të mos ishte i disponueshëm për publikun.




Figura 29. Në fund të punës së vet, KVP do të publikojë një raport me gjetjet. Si mendoni se duhet të publikohet ky raport?

Në përputhje me këtë pyetje, të anketuarit u pyetën se cili organ/njësi ose institucion duhet të jetë përgjegjës për të monitoruar dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raporti përfundimtar i KVP (shiko Figurën 30). Më se gjysma (54%) deklaruan se duhet të jetë KVP (ose njësitë e saj) që monitoron dhe vepron si kontrollues i zbatimit të rekomandimeve të veta nga qeveria, dhe më pas i raporton përsëri publikut të gjerë. Për më tej, e njëjta përqindje e të anketuarve besojnë se zbatimi i rekomandimeve të KVP-së duhet të jetë ligjërish i detyrueshëm, kurse 41% e të anketuarve pohojnë se zbatimi duhet të sigurohet përmes ndonjë organi/ institucioni monitorues. Njëkohësisht, vetëm 28% e të anketuarve mendojnë se moszbatimi i rekomandimeve të raportit të KVP duhet të ketë pasoja.




Figura 30. Si mendoni se duhet të sigurohet zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti nga institucionet përkatëse?

Pyetja përfundimtare ishte nëse do të kishte një aspekt që mund t'i parandalojë që të anketuarit t'i besojnë KVP-së dhe konkluzave të saj nëse do të themelohej (shiko Figurën 31). Siç treguan rezultatet, më pak se një përqind (n=6) u përgjigjën pozitivisht, duke përmendur korrupsionin dhe paragjykimet si faktorë parandalues. Ndërsa 30% deklaruan se nuk ishin të sigurt, duke e lënë shumicën mbizotëruese prej 69% të pohonte se nuk kishte arsye të tjera që do t'i pengonin që t'i besonin KVP-së.




Figura 31. Me supozimin se KVP do të themelohet dhe do të performojë në bazë të preferencave që ju ofruat, a do të mbetet ende ndonjë aspekt që t'ju pengonte të keni besim në KVP?

Përfundime

Ky studim synoi të vlerësonte njohuritë dhe mendimet e qytetarëve të Kosovës të të gjitha etnitve, sektorëve, moshave dhe gjinive, për konceptet e të vërtetës dhe pajtimit dhe ua mbledhi pikëpamjet për krijimin e propozuar të një Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovën.

Për fillim, shumica e të anketuarve kurrë nuk kishin dëgjuar për iniciativën rreth një KVP-je për Kosovën. Sidoqoftë, e vërteta për të kaluarën e dhunshme u mbajt si e rëndësishme nga shumica e të anketuarve, edhe nëse kjo do të zbulonte fakte të pakëndshme për grupin vetjak ose informacione të panjohura më parë. Faktet për të kaluarën janë domosdoshmëri për ta arritur pajtimin. Pajtimi në përgjithësi u kuptua si proces drejt paqes, respektimit të të drejtave individuale të njeriut dhe bashkëjetesës etnike. Për të arritur pajtimin në Kosovë, të anketuarit u pajtuan në një masë të madhe se zbulimi i të vërtetës është i domosdoshëm, si dhe kërkimi i përgjegjësisë prej përgjegjësve përmes mjeteve ligjore.

Për të anketuarit shqiptarë do të ishte shumë e rëndësishme që Qeveritë e Kosovës dhe të Serbisë ta konsideronin pajtimin seriozisht. Ata e shohin edhe kërkimfaljen nga Qeveria serbe si parakusht për pajtim. Pjesëmarrësit serbë sidoqoftë, menduan se pajtimi duhet bërë midis bashkësive para së gjithash. Lidhur me këtë, të anketuarit theksuan shumë qartë se nuk kanë besim të mjaftueshëm në institucionet shtetërore, veçmas kur bëhet fjalë për çështjen e korrupsionit dhe të sistemit juridik. Pjesëmarrësit në GF u dakorduan se pajtimi është çështje komplekse, që kërkon ndryshime substanciale brenda dhe ndërmjet bashkësive. Për shkak të mungesës së besimit në institucionet dhe udhëheqësit politikë, si dhe mosbesimit midis komuniteteve, ata besojnë se pajtimi, përtej nivelit individual, vështirë do të arrihet në vitet e ardhshme.

Kur informohen për të Drejtën e së Vërtetës dhe shpjegime të mëtejshme për rolin e komisioneve të të vërtetës, rreth dy të tretat e të anketuarve preferojnë themelimin e KVP-së, e cila shihet si e nevojshme dhe e dobishme. Do të ishte e mirë që themelimi i KVP-së të ndodhë tani, pasi shumë njerëz kanë frikë se provat po humbin me kalimin e viteve. Ndërsa shumica e shqiptarëve mbështesin krijimin e një KVP-je në Kosovë, gjysma e serbëve ishin të pasigurt dhe një e pesta nuk e mbështesin fare KVP-në. Arsytet e rëndësishme mes të anketuarve për të mos e mbështetur KVP-në janë mungesa e besimit se ajo do të ketë sukses dhe fakti se nisma erdhi nga Presidenti i Kosovës.

Disa prej të anketuarve u shprehën negativisht lidhur me përkrahjen e themelimit të KVP-së sepse e lidhin ngushtë punën e saj me faljen e keqbërësve. Sidoqoftë, kjo nuk është pjesë e Aktit Normativ aktual dhe Ekipi Përgatitor duhet t'i informojë qartë qytetarët se kjo nuk është brenda objektivave të KVP-së për Kosovën.

Është e qartë se ka dallime të dukshme në opinione midis shqiptarëve dhe serbëve mbi çështjen se cila palë ka kryer shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe kush duhet të mbahet përgjegjës për

të ligat e kaluara. Ekzistojnë edhe dallime të dukshme se ç'lloj krimesh mendojnë që KVP duhet të hetojë, me përjashtim të vrasjeve në masë, që i konsideruan të rëndësishme të gjithë. Kjo lidhet me përvojat, tregimet dhe narrativat e ndryshme që kanë ndërtuar komunitetet e ndryshme deri më tani. Njëherësh, një shumicë e konsiderueshme u pajtua që qytetarët e Kosovës kanë informata të mjaftueshme mbi faktet dhe të vërtetat e të kaluarës në lidhje me konfliktin '98/'99. Këtu këshillohet kujdes meqë kjo mund të tregojë mungesë të mendimit kritik apo mosnjohje se si është dokumentuar e shkuara deri më tani, dhe mbi narrativat zyrtare të ofruara që nga fundi i konfliktit. Këto narrativa janë ngulitur në kujtimet dhe besimet e shumë qytetarëve, por duhen vënë në pyetje dhe rishqyrtuar.

Me sa duket, dallimet e mësipërme sqarojnë pse nuk kishte konsensus të qartë se saktësisht cila periudhë duhet të hetohet dhe të dokumentohet nga KVP. KVP duhet të ketë mandat të qartë për ta hulumtuar një periudhë të caktuar; ndonëse KVP mund të përfshijë të dhëna më të gjera historike në raportimin e saj, hetimi dhe dokumentacioni i shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut duhet të kufizohen në një hark kohor të përcaktuar. Përvojat dhe narrativat e ndryshme për të kaluarën midis bashkësive të ndryshme vijnë në një mjedis mosbesimi dhe thartësie, dhe kjo është një nga arsyet kryesore pse nevojitet një KVP. Duhet të jetë Komision i pavarur që do ta hulumtonte dhe dokumentonte të vërtetën e pashpallur në lidhje me konfliktin e fundit në Kosovë duke mos e nxjerrë një grup a një tjetër të gabuar, por të shpalosë në nivel shoqëror si modelet ashtu edhe numrin e shkeljeve të shkaktuara. Për më shumë, kjo do t'i shfaqte vuajtjet e viktimave nga komunitete të ndryshme ndaj njëri-tjetrit. Kjo në planin afatgjatë do të krijojë kushte për krijimin e një dialogu shoqëror.

Për ata që e duan KVP-në të themeluar është me rëndësi që ajo t'i plotësojë disa kritere të caktuara si: besueshmëria, transparenca, pavarësia politike dhe financiare, zgjedhja e kujdesshme e komisionerëve, përfshirë kuotat për gratë dhe pakicat etnike.

Ndërtimi i një KVP-je të suksesshme është proces kompleks dhe shumë kërkuar. Shoqëria kosovare duhet të tregojë gatishmëri dhe përgjegjësi për të ndërtuar një KVP që do të krijojë hapësirë për viktimat dhe të mbijetuarit e luftës, dhe të dokumentojë të vërtetat, deri tani të pathëna. Kjo e vërtetë duhet të krijojë një hapësirë në të cilën shqiptarët, serbët dhe komunitetet e tjera dëgjojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë vuajtjet dhe humbjet e ndërsjella gjatë konfliktit të fundit. Një e vërtetë që mund të pranohet pa ngurrim nga të gjitha grupet etnike në Kosovë. Vetëm atëherë, TRC mund të ndihmojë në krijimin e kushteve më të mira për pajtimin

Rekomandime

Bazuar në diskutimin e mësipërm, më poshtë janë rekomandimet për një sërë palësh interesi se si të vazhdohet më tej.

Ekipi Përgatitor për krijimin e një KVP-je në Kosovë duhet:

- Të krijojë një strategji gjithëpërfshirëse për të siguruar informacione të qarta në lidhje me gjithë procesin për themelimin e KVP-së dhe funksionimin e saj. Së pari dhe mbi të gjitha të shtrihet tek të gjitha komunitetet dhe palët e interesit në Kosovë, por edhe në diasporën dhe aktorët përkatës ndërkombëtarë;
- Përmes konsultimeve dhe debateve të gjera e gjithëpërfshirëse shtetërore, t'i përfshijë të gjitha grupet shoqërore në Kosovë, me qëllim krijimin e konsensusit rreth qëllimit dhe rrezeveprimit të KVP-së;
- Të sigurojë përfshirjen sa më të gjerë të pakicave kosovare në diskutimet rreth së vërtetës për të kaluarën, pajtimin, si dhe për KVP-në;
- Të sigurohet që të merren parasysh pikëpamjet e qytetarëve dhe palëve të interesuara për kornizën kohore që duhet të hulumtohet nga KVP, që të jetë e ndjeshme ndaj përvojave të larmishme të grupeve të ndryshme etnike;
- Të sigurojë zbatimin e sugjerimeve për Aktin Normativ, të dalë nga një debat publik gjithëpërfshirës, dhe gjetjet e këtij studimi, që komisionerët të zgjidhen nga Parlamenti, bazuar në listën e nominimeve të dhëna nga një komision përzgjedhës i përbërë nga viktima të luftës, OJQ-të, mediat dhe publiku i gjerë;
- Të sigurojë krijimin e KVP-së me akt legjislativ të dalë nga një debat publik gjithëpërfshirës, dhe se gjetjet e këtij studimi janë qasje më e besueshme sesa përcaktimi me dekret presidencial;
- Të sigurohet që të ketë kuota si veprim pohues në sigurimin e përfaqësimit të mjaftueshëm të grave dhe të grupeve të pakicave etnike si komisionerë të KVP-së;
- Të shqyrtojë sugjerimet e qytetarëve nga ky hulumtim, por edhe sugjerimet që do të dalin nga cikli i dytë i konsultimit publik mbi harkun kohor që do të hetohet nga KVP-ja (midis çështjeve të tjera), përpara se të finalizojë Aktin Normativ për KVP-në.

Qeveria e Kosovës:

- Ky studim tregon se qytetarët e Kosovës kanë nevojë për fakte të përcaktuara në mënyrë të pavarur mbi të kaluarën e dhunshme, drejt një procesi të pajtimit. Prandaj, qeveria e Kosovës duhet të përmbushë detyrimet e saj në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe detyrimeve të tjera ndërkombëtare që ka marrë përsipër Kosova, dhe t'i vazhdojë përpjekjet e mëtutjeshme drejt pajtimit, çka është thelbësore për të rrënjosur fort paqen dhe për të siguruar stabilitet të qëndrueshëm në Kosovë;

- Ta riafirmojë përkushtimin dhe pranoj nevojën për dialogun Kosovë-Serbi dhe ta rifilloj këtë proces me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve midis dy shoqërive, përtej arritjes së *marrëveshjes përfundimtare* ‘teknike’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- Të sigurohet që pas themelimit, KVP-së do t'i jepet autoriteti i mjaftueshëm për të kryer punën e vet në mënyrë të pavarur, në përputhje me dëshirat e qytetarëve;
- Ta përkrahë KVP-në politikisht duke bashkëpunuar plotësisht e duke parandaluar çdo pengesë;
- Të sigurojë mjete të nevojshme financiare për KVP-në që të zbatojë plotësisht mandatin e vet;
- Të shtojë përpjekjet për ta luftuar korrupsionin nëpërmjet një sistemi të drejtësisë së lirë e të drejtë, pasi në të kundërtën do të pengonte punën e KVP dhe do të ndikonte në besueshmërinë e saj;
- Të ofrojë informacion të plotë në lidhje me personat e pagjetur pasi të jetë krijuar KVP-ja. Ky studim tregon se informacioni për personat e pagjetur është thelbësor që shoqëria të jetë në gjendje të ecë përpara;
- Të sigurohet që Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (SPRK) dhe hetuesit e specializuar të policisë së Kosovës për Krime Luftë të kenë personel dhe burime të mjaftueshme profesionale dhe të trajnuar për ta përkrahur Komisionin kur rastet e krimeve të luftës duhen paraqitur për ndjekje penale, duke respektuar të drejtat e viktimave dhe të mbijetuarve;
- Ta përkrahë krijimin e një mekanizmi për të monitoruar punën e KVP.

Kuvendi i Kosovës:

- Ta shqyrtojë seriozisht miratimin e Aktit Normativ për krijimin e KVP-së pasi t'i jetë dorëzuar;
- Të sigurohet që në diskutim, Kuvendi i Kosovës të vlerësojë se si Akti i përgjigjet pikëpamjeve të ndryshme brenda shoqërisë;
- Të sigurojë që Komisionerët të emërohen në mënyrë transparente, sipas një liste të të nominimeve të paraqitura nga një komitet përzgjedhës i përbërë nga viktimat e luftës, OJQ-të, mediat dhe publiku i përgjithshëm.

Shoqëria civile:

- Ta monitorojë krijimin dhe funksionimin e KVP-së së ardhshme;
- Të vazhdojë me zbatimin e aktiviteteve që përkrahin dialogun etnik dhe pajtimin në nivele individuale dhe komunitare;
- Të vazhdojë të punojë ngushtë me të rinjtë në shkollat fillore dhe të mesme për të ofruar materiale faktike arsimore lidhur me të kaluarën e fundit në Kosovë;

- Ta përkrahë KVP-në e ardhshme duke transferuar te KVP-ja të gjitha dosjet e çështjeve të mbledhura nga OJQ-të dhe çdo lloj dokumentacioni ose provë shoqëruese lidhur me krimet e kryera gjatë konfliktit të fundit.

Bashkësia ndërkombëtare:

- Ta njohë nevojën për gjetjen e të vërtetës si parakusht për pajtim, dhe të dyja si elemente të rëndësishme të marrëdhënieve midis qeverive dhe qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë;
- Të ofrojë përkrahje politike dhe teknike për KVP-në ashtu që të mund të funksionojë e pavarur dhe plotësisht, duke mos imponuar asgjë;
- Të ofrojë përkrahje për spektrin politik në Kosovë për me mbështetë krijimin e KVP-së;
- Të vazhdojë t'i mbështesë përpjekjet e Kosovës për ta forcuar demokracinë dhe shtetin ligjor.

BE veçanërisht:

- Brenda programit të parapranimit dhe në kontekstin e reformave të kërkuara nga Komisioni Evropian, ta nënvizojë nevojën për drejtësi tranzicionale në Kosovë dhe ta përkrahë Kosovën me asistencë teknike;
- Ta përkrahë krijimin e KVP brenda kontekstit të bisedimeve të nivelit të lartë për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës;
- Ta përkrahë pavarësinë e punës së Komisionit, hulumtimin dhe arkivimin e dokumentacionit prej tij;
- Ta monitorojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga raporti përfundimtar i KVP-së.

UNMIK-u dhe EULEX-i:

- Të sigurohen që të gjitha dosjet e çështjeve dhe çdo dokumentacion ose provë e lidhur me raportet, dhe hetimet për krimet sipas ligjit ndërkombëtar që ende mbahen nga UNMIK dhe EULEX të transferohen pa vonesë të mëtejshme në SPRK dhe/ose KVP-në e ardhshme.

Integra

Integra është organizatë e formuar nga një grup njerëzish të përkushtuar për të kontribuar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e Kosovës dhe të rajonit. Puna e Integra-s udhëhiqet nga parimet e qeverisjes së mirë dhe gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, pavarësisht prej përkatësisë etnike, racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual dhe përkatësisë politike, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e një Kosove demokratike dhe tolerante, të integruar plotësisht në Bashkësinë Evropiane.

www.ngo-integra.org | info@ngo-integra.org

Ky studim është rezultat i projektit/aktivitetit “Matja e perceptimit publik, dhe dialogu publik rreth Komisionit të Ardhshëm për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP) në Kosovë”, financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës. Përmbajtja dhe rezultatet e këtij studimi janë përgjegjësi e organizatës INTEGRA dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se përfaqësojnë qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

The background of the page is an abstract, low-poly geometric design in various shades of blue. The shapes are irregular polygons that create a sense of depth and movement, with some areas being a deep navy blue and others a lighter, sky blue. The overall effect is modern and dynamic.

Fuqizuar nga Integra

Në partneritet me Nismën e Re Sociale (NRS)

Autorizuar nga Ekipi Përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin

Mbështetur nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë, Ambasada e Zvicrës në Kosovë

dhe Fondacioni I Vëllezërve Rockefeller

Duke faleminderuar Qendrën Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT)

dhe PAX për këshilladhe rishikim të gjithëmbarshëm